



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 04

Prishtinë, më 08 shkurt 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 225

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Selvije Halimi, Ramadan Gashi, Ibrahim Makoll, Adem Salihaj, Vladimir Todoroviq dhe Kolë Berisha.

Munguan: Armend Zemaj dhe Mufera Şinik – ishin në udhëtim zyrtar.

Pjesëmarrës të tjerë: Shqipe Arifaj - Asociacioni i Komunave të Kosovës, Lumnije Muarti – ZPRK, Saranda Stublla - Lëvizja FOL, Shefki Kastrati – NDI, Sylë Ahmeti – Kosova Sot dhe Visar Krasniqi – Zyra e Komisioneve të Kuvendit.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 1 shkurtit 2010,
3. Shqyrtimi i çështjes së anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës që u ka kaluar mandati,
4. Identifikimi i aktiviteteve të Komisionit me ngarkesat buxhetore të përcaktuara në planin e punës dhe konsultimet për planin financiar për vitin 2010,
5. Konsultimet për vizitat jashtë vendit dhe për angazhimin e ekspertëve për shqyrtimin e Projektligjeve me përkrahjen e OSBE - së,
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 1 shkurtit 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 01 shkurt 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i çështjes së anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, që u ka kaluar mandati

Kryetari - I njoftoi se Këshilli drejtues nuk ka mandat, gjegjësisht një numër i madh i anëtarëve të këtij këshilli ju ka skaduar mandati. Kuvendi Kosovës nuk e ka përkrahur propozimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, sepse asnjë nga institucionet nuk kanë propozuar anëtarë nga radhët e komuniteteve, edhe pse Komisioni në rekomandim e ka përcaktuar këtë fakt. Prandaj ne, si Komision, t'i drejtohem me shkresë institutit, sepse ky këshill është duke funksionuar pa bazë ligjore dhe të kërkojmë nga institucionet relevante që konform ligjit t'i paraqesin urgjentisht propozimet.

Ibrahim Makolli - Tha se një numër i madh i institucioneve në Kosovë janë duke vepruar në kundërshtim me Ligjin. Njoftimi se këtyre anëtarëve ju ka skaduar afati t'i procedohen Kuvendit tre muaj pasi atyre veç ju ka skaduar mandati. Do të ishte mirë që këtyre institucioneve t'u kërkohej që së paku një muaj para se të ju skadojë afati anëtarëve të tyre të njoftohet Kuvendi dhe të fillojë procedura për përzgjedhjen e anëtarëve të rinj.

Kryetari - Duke u ndërlidhur me parafolësin, tha se procedurën e kemi filluar me kohë, mirëpo propozimet e kandidatëve nuk kanë qenë në përputhje me Ligjin. Ne, si Komision, do të mund të kërkojmë sqarim nga Instituti Gjyqësor se mbi cilën bazë bëhen pagesat, pse propozimet e Institutit janë sjellë në Kuvend, pasi që janë refuzuar kandidatët nga Kuvendi Kosovës. Në vazhdim tha se një përgjegjësi e madhe bie mbi sekretarin e këtij instituti.

Komisioni pas një diskutimi vendosi që me shkresë t'i drejtohet Institutit Gjyqësor të Kosovës me të cilën do të kërkojë që të sjellë propozimet për anëtarët e këtij këshilli, në pajtim me Ligjin.

4. Identifikimi i aktiviteteve të Komisionit me ngarkesat buxhetore të përcaktuara në planin e punës dhe konsultimet për planin financiar për vitin 2010

Kryetari - Tha se në bashkëpunim me administratën e Kuvendit e kam përfunduar çështjen rreth listës së eksperteve të përcaktuar në *data bazë*. Ne, si Komision, mund të marrim vendim, ta bëjmë një listë tjetër të ekspertëve të profileve të ndryshme dhe ta dërgojmë në administratën e Kuvendit, kjo do të thotë që nuk kemi më nevojë të bëjmë shpalljen publike për angazhimin e ekspertëve.

Ibrahim Makolli - Në fjalën e tij të sërishme tha se nëse Komisioni do ta bëjë një listë të ekspertëve, atëherë çka nëse gjatë punës së Komisionit na nevojitet ndonjë ekspert i një profili që nuk është përfshirë në listë. Pyeti: ne a do të mund ta ndryshojmë këtë listë? Sepse Komisioni angazhon ekspertë sipas nevojës dhe sipas kohës kur i nevojiten, ndërsa administrata vetëm njoftohet për punën e Komisionit. Në vazhdim shtoi se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi është ndër Komisionit kryesore të Kuvendit edhe me këtë dinamik të punës do të duhej që ju, si kryetar i Komisionit, të kërkonte nga Kryesia e Kuvendit që ky komision të mbështet së paku edhe me dy ekspertë.

Komisioni diskutoi dhe identifikoi detyrimet që do të jenë pjesë e aktivitetit të Komisionit për vitin 2010, u përcaktuan afatet kohore të realizimit të këtyre detyrimeve, ku si pjesë përbërëse e planit të punës së Komisionit do të jetë edhe plani financiar dedikuar Komisionit për këtë vit. Komisioni mori përkrahje nga OSBE - ja se do të ndihmohet në aspektin financiar në realizimin e takimeve të punës, ndërsa buxheti i Komisionit u përcaktua në realizimin e dëgjimeve publike dhe angazhimin e ekspertëve.

5. Konsultimet për vizitat jashtë vendit dhe për angazhimin e ekspertëve për shqyrtimin e Projektligjeve me përkrahjen e OSBE - së

Komisioni u njoftua nga përfaqësuesi i OSBE - së për gatishmërinë në realizimin e një vizite të Komisionit jashtë vendit, si mundësi u propozua vizita në Hungari – Budapest në muajin mars. Në vazhdim ceku se do të shikohet mundësia në realizimin edhe të një vizite të mundshme pas muajit gusht.

6. Të ndryshme

Kryetari i njoftoi anëtarët me Propozimvendimin e Ministrisë së Drejtësisë nr. 02/L-40. Ky propozim ka ardhur në momentin e fundit nga ministrja dhe është në pajtim me Ligjin. Prandaj ne, si Komision, ta rekomandojmë për shqyrtim dhe votim në seancë plenare bashkë me propozimet për dy kandidatët e tjerë.

Komisioni unanimisht u pajtua që pjesë e rekomandimit të Komisionit që i është dërguar Kuvendit të jetë edhe propozimi i fundit i kandidatit Adem Vokshi:

Të emërohet Adem Vokshi, anëtar i Komisionit për provimin e jurisprudencës, i propozuar për lëndët civile.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni